



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Zyra për Komunikim me Publikun
Kancelarija za Javno Komuniciranje
Office of Public Communication

THIRRJE PËR APLIKIM

Për Pagesa Direkte në Blegtori për vitin 2013 (Lopë, buallica, dele dhe dhi në prodhimtarinë aktive të qumështit dhe bletë)

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe këtë vit do të vazhdojë të mbështesë sektorin e blegtorisë përmes pagesave direkte. Niveli i mbështetjes planifikohet të jetë:

- Lopë qumështore _____ 50 € për krerë
- Buallica qumështore _____ 50 € për krerë
- Dele dhe dhi qumështore _____ 10 € për krerë
- Bletari _____ 10 € për koshere

Fermerët aplikues duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë minimum 5 krerë lopë qumështore dhe buallica qumështore ose gjithsej 5 krerë lopë qumështore dhe buallica qumështore së bashku, dhe në maksimum 50 krerë në prodhimtarinë aktive të qumështit;
- Të kenë minimum 30 krerë dhe në maksimum 500 krerë dele në prodhimtarinë aktive të qumështit;
- Të kenë minimum 20 krerë dhe në maksimum 500 krerë dhi në prodhimtarinë aktive të qumështit;
- Të kenë minimum 30 dhe në maksimum 500 shoqëri bletësh (koshere);
- Kafshët duhet të jenë të matrikuara me matrikul të Republikës së Kosovës ose me matrikul të vendeve anëtare të BE-së;
- Fermeri bletarë mund t'i ketë të vendosura shoqëritë e bletëve (kosheret) më së shumti në tri (3) bletishte;

- Kosheret duhet të jenë të shënjuara me numër identifikues të pronës, sipas një rregullimi të brendshëm nga MBPZHR-ja (lidhur me këtë fermerët do të njoftohen në momentin e aplikimit);
- Të jenë të regjistruar në regjistrin e fermës.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Fotokopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Fotokopjen e xhirrollogarisë bankare personale, e vlefshme në ndonjërin nga bankat që operojnë në Republikën e Kosovës;
- Regjistrin e kafshëve për: lopët qumështore, Buallicat qumështore, delet dhe dhitë qumështore të lëshuar nga Sektori i Identifikimit dhe Regjistrimit të Kafshëve/AUV;
- Dëshmi se është anëtar i ndonjë shoqate lokale bletare;
- Dëshmi që është i regjistruar në regjistrin e fermës;
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë.

Periudha e aplikimit:

Aplikimi zgjatë 45 ditë kalendarike dhe fillon prej momentit të shpalljes publike.

Aplikimi duhet të bëhet në zyrat e Drejtorive Komunale për Bujqësi.

Mënyra e aplikimit:

Fillimisht të gjithë fermerët, gjatë aplikimit janë të obliguar të plotësojnë formularin për regjistrim në Regjistrin e fermerëve, i cili është parakusht për përfitimin e mbështetjes.

Formulari për aplikim për pagesa direkte do të jetë i njëjtë për të katër kategoritë të cilat do të subvencionohen (lopë qumështore, buallica qumështore, dele dhe dhi qumështore dhe bletë).

Departamenti i Pagesave, i cili vepron në kuadër të MBPZHR-së, do ta menaxhojë implementimin e Programit për Pagesat Direkte në Bujqësi.

Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve do të aplikohen masa ndëshkimore, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për pagesat direkte në lëmin e bujqësisë.

Sqarim:

Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në dy kopje brenda periudhës së aplikimit.

Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar nuk do të pranohet për shqyrtim.

Regjistrin e kafshëve, fermerët mund ta marrin në stacionet e autorizuara nga AUV sipas tabelës ne vijim:

NR	EMRI VETERINARIT	AMBULANCA VETERINARE	KOMUNA
1	QERIM PEP SHI	A.V."QERIM PEP SHI"	DEQAN
2	REXHEP SHALA	STACIONI VETERINAR"R"	DRAGASH
3	TASIM SHERIFI	A.V."TASVET" AGROVET	DRAGASH

4	SEFEDIN HETA	A.V."VETERINA"	DRENAS
5	KUSHTRIM REXHEPI	A.V. " VETERINARIA "	FERIZAJ
6	MALE IBRAJ	A.V. " MGvet "	FUSHE KOSOVE
7	MALE IBRAJ	A.V. " MGvet "	GJAKOVE
8	ZIJAH IDRIZI	S.V."FAUNA"	GJILAN dhe NOVOBERD
9	HAKI BYTYQI	STACIONI VETERINAR	ISTOG
10	NUHI PROVOLIU	A.V. " ERB-MEDIKUS "	KAÇANIK
11	ARBEN SINANI	A.V. "VETERINA"-KAMENICE	KAMENICE
12	JOSIP TOPLANAJ	STACIONI VETERINAR KLINE	KLINE
13	BUJAR EJUPI	AM.VET."VETERINA"-LIPJAN	LIPJAN
14	AVNI ROBAJ	A.V."ENKELI-MED-VET"	MALISHEVE
15	AVNI KADRIU	A.V.VETERINA	MITROVICE
16	URAN REXHEPI	A.V. " MEDICAL "	OBILIQ
17	HENRIK NULLESHI	STACIONI VETERINAR	PEJE
18	HAMDI ALIU	A.V. " VETERINARIA "	PODUJEVE
19	SHAIP BERISHA	STACIONI VETERINAR	PODUJEVE
20	KORAB GUNGA	A.V. "SPANAN"	PRISHTINE
21	ARSIM HIMBEQA	STACIONI VETERINAR	PRIZREN
22	SALI THAQI	A.V. "JONI"	RAHOVEC
23	LUBISHA RISTIC	A.V."VETKOS"	RANILLUGE - KAMENICE
24	HYZRI YMERI	A.V."VETERINA-MED"	SHTERPCE
25	XHEVDET KRASNIQI	A.V. VETERINAKOS	SHTIME
26	ISTREF GASHI	A.V. " FAUNA "	SKENDERAJ
27	KRESHNIK RUGOVA	STACIONI VETERINAR	SUHAREKE
28	NUE MARKU	NTP " FARMVET "	VITI
29	FEVZI GERGJALLIU	PHARMACON VET	VUSHTRRI
30	MUHEDIN HOGAN	V.S."HOGAN"	ZVECAN